

SHKOLLA PËR POLITIKA për vitin 2021

Pyetje të parashtruara shpesh:

- 1. Kur dhe në çfarë formati do të organizohen modulet e Shkollës për politika?**
 - Shkolla për politika do të organizohet në 4 module, në kohëzgjatje prej 4 fundjavësh. Çdo modul do të zgjasë sa një fundjavë. Fundjavët, përkatësisht modulet nuk do të jenë një pas nj. Moduli do zgjasë nga e premtja në orët e pasdites deri të dielën në orët e pasdites. Moduli i parë është parashikuar të mbahet në fund të muajit mars 2021. Duke pasur parasysh masat dhe protokollet për punë në kohë pandemie me virusin covid-19 ekziston mundësia disa module të mbahen onlajn, edhe pse QPEP-ja do të këmbëngulë që modulet të mbahen drejtpërdrejt, në qytete të ndryshme në shtet.
- 2. Në cilat gjuhë duhet të dërgohen dokumentet e nevojshme për aplikim në Shkollën për politika?**
 - Dokumentet për aplikim mund t'i dërgoni në një nga gjuhët e punës të Shkollës për politika - maqedonisht, shqip ose anglisht, sipas përzgjedhjes së aplikuesit.
- 3. A duhet të dërgohen aplikimet edhe me postë?**
 - Jo, aplikimet duhet të dërgohen vetëm në postën elektronike: L.matevska@president.mk.
- 4. A është e nevojshme të shkruhen dy ese? A është eseja e kufizuar se sa fjalë duhet të ketë? Në çfarë formati duhet të dërgohet eseja?**
 - Si pjesë e aplikimit për në Shkollën për politika, nevojitet të shkruhet vetëm një ese, për njërën nga dy temat e ofruar, me përzgjedhje të aplikuesit. Eseja nuk është e kufizuar për numrin e fjalëve dhe mund të dërgohet në formatin Word ose PDF, sipas përzgjedhjes së aplikuesit.
- 5. A është kufiri i moshës i pjesëmarrësve i pandryshueshëm, a mund të bëhet përjashtim?**

Kufiri i moshës, si dhe kushtet e tjera për pjesëmarrje në Shkollat për politika janë përcaktuar nga Këshilli i programit të Qendrës Presidenciale për Edukim Politik.
- 6. A duhet të jenë rekomandimet për Shkollën për politika duhet të jenë me shkrim apo mund të vendosen vetëm informacionet për kontakt të profesorëve/punëdhënësve/bashkëpunëtorëve nga të cilët jepet rekomandimi?**
 - Të dyja rekomandimet duhet të jenë me shkrim.

7. Çfarë fitojnë pjesëmarrësit nga pjesëmarrja në Shkollën për politika?

- Pjesëmarrësit në Shkollën për politika do të fitojnë mundësinë të njihen me profesorë me renome, ekspertë, politikanë dhe anëtarë të bashkësisë së biznesit nga vendi dhe jashtë. Pjesëmarrësit do të mund të shkëmbejnë mendime dhe do të shkëmbejnë përvojat nga shumë sfera të jetës shoqërore dhe politike në shtet, si dhe do t'i përforcojnë shkathtësitë e tyre komunikuese, lidere dhe shkathtësitë e buta. Do të kenë mundësi të ndërtojnë miqësi shumëvjeçare dhe kontakte të rëndësishme, duke punuar në grupe dhe në mënyrë individuale në punëtoritë interaktive me profesionistë nga shumë fusha. Në fund, do të mund t'i përparojnë njohuritë e veta, duke përpunuar shumë tema nga politika, e drejta, demokracia, eurointegrimet, bashkëpunimin e jashtëm, marrëdhëniet me publikun, komunikimet, mjedisin jetësor, zhvillimin e qëndrueshëm, mediat e reja e të tjera.